

Analiza vjetore 2019

Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Në datën 29 Janar 2019, Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja në zbatim të urdhrit nr. 6, datë 23.01.2020 “Për kryerjen e analizës vjetore të veprimtarisë së departamenteve të KLSH-se për vitin 2019” ka zhvilluar në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në sallën “**Gene Dodaro**”, analizën vjetore të vitit 2019, duke u bazuar në këto drejtime:

- Gjetjet, rekomandimet dhe statistikat vjetore;
- Analizën e dy auditimeve më të mira;
- Analizën e dy auditimeve më të dobta;
- Diskutimet e dy botimeve të KLSH të vitit 2019.

Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç drejtuesve dhe audituesve të departamentit, ishin edhe Drejtori i Përgjithshëm, znj. Manjola Naço, Drejtori i Standardeve dhe Sigurimit të Cilesisë, si dhe audituesit e kësaj drejtorie, të cilët kanë kryer kontrollin mbi cilësinë e disa dosjeve të auditimit të Departamentit.

Analiza vjetore filloi me fjalën hyrëse të Drejtoreshës së Departamentit znj. Yllka Pulashi, e cila vijoi edhe me përmbledhjen e veprimtarisë audituese, duke u përqendruar kryesisht në statistikat vjetore për plotësimin e programit vjetor të auditimit, rezultatet e tyre të shprehura në rekomandime për përmirësime e ndryshime ligjore, masat organizative, ato administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit së bashku me vlerën e tyre, rastet dhe numrin e kallëzimeve/indicieve penale. Gjithashtu u paraqit analiza e punës një vjeçare të Departamentit duke u analizuar sipas elementëve të Matjes së Performancës fuqive/dobësive/mundësive/kërcënimeve.

Gjithashtu znj. Pulashi u ndal edhe në veprimtarinë e audituesve të Departamentit në drejtim të pjesëmarrjes në trajnime, cilësinë e auditimit, prezencën e audituesve në mediane e shkruar, planin e auditimit për vitin 2020, si dhe objektivat kryesore që duhet të përmbushen për realizimin e planit dhe të veprimtarisë audituese për vitin 2020.

Në vazhdim fjalën e mori Drejtoresha e Përgjithshme znj. Manjola Naço, e cila ndër të tjera vendosi theksin në objektivat dhe sfidat që na presin në vitin 2020, në veçanti në kryerjen e auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë, në zbatim të manualeve përkatëse dhe në përgatitjen e letrave të punës sipas manualeve përkatëse, dokumente këto që janë në fazën e konsolidimit. Në fjalën e saj theksin e vendosi në kujdesin që duhet të tregojmë në plotësimin e letrave të punës gjatë procesit të auditimit, në metodat e perzgjedhjes së materialitetit, percaktimin e riskut, në dokumentimin e çdo faze auditimi, në hartimin dhe dhenien e opinionit të auditimit, si dhe në përmbushjen e objektiveve dhe realizimin e auditimeve për vitin 2020, në frymën e një ekipi të vetëm, duke respektuar rregulloren e Procedurave të Auditimit.



Analiza pati si qëllim dhënien e një panorame të përgjithshme të rezultateve, arritjeve kryesore në funksion të përmbushjes së objektivave të Departamenteve si dhe ato institucionale, por edhe në funksion të rritjes së figurës së audituesit dhe të besueshmërisë në kapacitetet dhe profesionalizmin e tij. Kjo qasje i jap cdo audituesi mundësinë, për t'u njohur më mirë me të metat dhe dobësitë në punë audituese, me qëllim identifikimin e tyre, duke analizuar risqet, duke i vlerësuar ato me përgjegjshmërinë më të lartë për zbutjen e tyre dhe përmirësimin e punës audituese në të ardhmen.

Sipas programit vjetor të auditimit për vitin 2019, Departamenti ka pasur si objektiv realizimin dhe përmbushjen e **23 auditimeve gjithsej**, 15 auditime në shoqëritë publike dhe 7 auditime të projekteve me financime të huaja dhe nje auditim mbi zbatimin e rekomandimeve. Në fund të vitit rezulton se numri i auditimeve të realizuara dhe të evaduara është 23 auditime.

Theksojmë faktin se të gjitha auditimet kanë qenë auditime përputhshmerie dhe kanë pasur si qëllim, që nëpërmjet gjetjeve të konstatuara dhe rekomandimeve të lëna në përfundim të tyre, të ndihmojnë subjektet e audituara në shmangin në vazhdimësi të parregullsive dhe të kenë ndikim pozitiv në përmirësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara.

Gjatë vitit 2019, auditimet e evaduara janë raportuar për pasqyrim në evidencat e përgjithshme të institucionit, në menyre të përmbledhur rezulton si vijon:

1. Janë rekomanduar 4 propozime për ndryshim ose përmirësim të bazës ligjore dhe këto për auditimin e kryer në QSUT dhe Rezidencën Studentore nr.1, Tirane;
2. Janë rekomanduar gjithsej **530 masa organizative**;
3. Janë rekomanduar **139 masave disiplinore dhe administrative**;
4. Masa për shpërbllim të dëmit ekonomik, eliminimin e shpenzimeve jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe të ardhura të munguara janë në shumën gjithsej **7,289,253 mijë lekë**, nga të cilat shuma **6,096,399 mijë lekë** i përket dëmit ekonomik dhe **1,192,854 mijë lekë** për efektin negativ financiar ose shpenzime jo në përputhje me parimin e 3-E-ve. Sipas fushave të auditimit përkatëse konstatohet:

Dëmi ekonomik:

Në Shoqëritë Publike në vlerën **5,592,374 mijë lekë** dhe në Projektet me Financime të Huaja në vlerën **104,025 mijë lekë**.

EEE:

Në Shoqëritë Publike në vlerën **1,173,754 mijë lekë** dhe në Projektet me Financime të Huaja në vlerën **19,100 mijë lekë**.

Për auditimet e ushtruara në vitin 2019 janë propozuar 5 raste per indicie/vlerësim të metejshem nga oragani i prokurorisë.



Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna për auditimet e mëparshme, Departamenti gjate vitit 2019 ka kryer auditime në zbatim të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve në 12 subjekte. Për rekomandimet e pazbatuara është ri-kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve subjekteve. Gjithashtu ne përmbushje dhe te detyrimeve qe na përcakton Rezoluta e Parlamentit, për zbatimin e rekomandimeve, raportimi mbi këto auditime i është përcjellë edhe Ministrisë përkatëse sipas vartësisë për shoqëritë publike.

Gjatë vitit 2019 stafi auditues i departamentit ka pasur disa lëvizje, ku janë largur dhe janë përfshirë disa auditues të tjerë me përvojë, por edhe auditues të ardhur rrishtazi, kështu numri i audituesve të rinj për vitin 2019 ka qene 4 për te cilet është treguar kujdes dhe janë angazhuar ne auditime nën mbikëqyrjen e audituesve më me përvojë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës por edhe përmbushjen me sa më shumë arritje te auditimeve. Gjithashtu u pasqyrua fakti qe audituesit kane arritur të përmbushin objektivin në lidhje me ditët e trajnimit vjetor, si audituesit me përvojë ashtu edhe audituesit e rinj, si dhe u identifikua përdorimi dhe domosdoshmëria e përdorimit në eficiencë të plotë të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Proceseve (REVZONE).

Aktiviteti vijoi me prezantimet e dy prej auditimeve më te mira të cilat u prezantuan nga audituesit: Z. Artan Topjana per auditimin e kryer ne subjektin “Albpetrol” SHA, z. Blerin Shkurti për auditimin e kryer ne subjektin Qendra Studimore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Gjithashtu u prezantuan dy nga auditimet, te cilat nuk kanë arritur rezultate dhe pritshemritë, konkretisht, auditimi ne subjektin Ujësjiellës Kanalizimet SHA, i cili u prezantua nga znj. Eneida Seraj dhe auditimi për projektin e BB “Ofrimi i shërbimeve me në qendër qytetarin”, prezantuar nga audituesja, znj. Jorida Zhegu.

Prezantimi i dy nga botimeve te KLSH per vitin 2019 u paraqit nga Kryeaudituesi z. Alfred Cako per botimin “*Audituesit e KLSH ne shtypin e perditshem Volumi XII (janar-shtator*

2019)” dhe audituesi z. Eduard Stafasani për botimin *Revista kërkimore shkencore “Auditimi publik” nr.21.*

Gjatë analizës u diskutua edhe në lidhje me vështirësitë e hasura në punën audituese dhe rritjen e cilësisë dhe standardizimit të punës audituese për vitin 2020, konkretisht diskutuan Kryeaudituesi z.F.Iliazi, audituesit B.Shkurti dhe ekspertja e jashtme znj. N. Piranjani,etj.

Në përfundim, drejtoresha e departamentit, znj. Yllka Pulashi, prezantoi objektivat kryesorë të Departamentit për vitin 2020, ndër të cilat; kryerjen e auditimeve në përputhje me standardet e auditimit dhe me praktikat më të mira të auditimit; përvetësimin e standardeve ISSAI dhe manualet e auditimit në zbatim të “Rregullores së procedurave të auditimit”, si dhe vënien e tyre në praktike gjatë punës audituese, në mënyrë specifike e Manualit të Perputhshmerise; rritja e kapaciteteve audituese dhe profesionale në dhënien e opinionëve për auditimit të Përputhshmërisë; realizimi i punës audituese me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë; forcimi i marrëdhënieve me koleget duke rritur përpjekjet dhe gadishmërinë për të punuar dhe bashkëvepruar në grup; përdorimi në mënyrë sistematike dhe në kohë realevi programit rev/zone, pasqyrimi i cdo faze të auditimit në këtë sistem sipas detyrimit të cdo audituesi, etj.